



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:243806

Datë: 05.09.2024

Numri i dokumentit: 06125132

K.DH.SH.II.nr.1391/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë,në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurimit: O.S., me numër personal ..., me vendbanim në Sh.B.A., me adresë në ..., New Jersey ..., e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve ‘Halimi Associates Law Firm’, me seli të zyrës në Mitrovicë, kundër kundërpropozuese L.K., me numër personal ..., me vendbanim në Prishtinë dhe V.P., shtetas i SH.B.A.-së, me numër pasaportë ..., që të dy bashkëpronar të ‘B...R...’L.L.C të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Agron Selima nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të masës së sigurisë, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë Departamenti per Ceshtje Ekonomike KE.nr.875/23 e dates; 05.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën; 02.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e propozuesit të masës së sigurimit O.S., me numër personal ..., me vendbanim në Sh.B.A., me adresë në ..., New Jersey ..., me autorizim Shoqëria e Avokatëve ‘Halimi Associates Laë Firm’, me seli të zyrës në Mitrovicë , dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr. 875/23 e dates; 05.04.2024.

Arsyetim

1 (5)

Gjykata Komerciale Dhomat e shkallës së Parë,-Departamenti i Përgjithshëm Për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor KE.nr.875/23 e dates; 05.04.2024, ka vendosur si në vijim;

“I.REFUZOHET si i pa bazuar propozimi i paditësit/propozuesit të masës së sigurisë O.S., me numër personal ..., me vendbanim në SHBA, me adresë në ...,New Jersey ..., e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve” Halimi Associates Law Firm”, me seli të zyrës në Mitrovicë, me të cilën ka kërkuar që ti ndalohej kundërshtarëve të sigurimit që ta tjetërsojnë, fshehin, ngarkojnë apo disponojnë me pasurinë nga e cila është drejtuar kërkesa, si dhe ky ndalim të evidentohet në regjistrin publik përkatës të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “B...R... L.L.C” me nr. unik identifikues ..., me numër të biznesit ..., adresa Vrellë, Prishtina Internacional Aeroport, Adem Jashari, Komuna e Lipjanit.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale kontestimore, si dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Kundërpropozuesit kanë paraqitur përgjigje në ankesë, me propozim që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e propozuesit dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:
Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Paditësi - Propozuesi i masës së sigurimit O.S. me autorizim Shoqëria e Avokatëve ‘Halimi Associates Law Firm’, në Gjykatën Komerciale ka parashtruar padi për anulimin e pjeshëm të kontartes mbi shitblerjen e aksioneve dhe të detyrohen të paditurat që paditësit të ja plotësojnë vlerën e plotë në mënyrë solidare, në bazë të ekspertit financiar të pavarur.Njëkohësisht ka kërkuar caktimin e masës së sigurisë dhe at që kundërshtarëve të

sigurimit/paditurëve që të ju ndalohet që ta tjetërsojnë, fshehë, ngarkojë apo disponojë me pasurinë kah e cila është drejtuar kërkesa.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se propozuesi i masës së sigurisë nuk ka ofruar prova bindëse me të cilat do të vërtetonte pretendimet e tij lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë dhe se nuk plotësohet kushtet ligjore nga nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë, repsektivisht ekzistimin i rrezikut se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështërsonte dukshëm realizimin e kërkesës ngase në këtë rast propozuesi i masës së sigurimit nuk e ka përcaktuar se kundërshtarët e propozimit cilën pasuri mund të fsheh, ngarkoj, apo ta tjetërsoj sepse kërkesa e parashtruar në padi është anulimi i pjesshëm i një kontrate-marrëveshje për shitëblerje të aksioneve, prandaj sipas vlerësimit të gjykatës pala kundërshtarë nuk mund të rrezikoj realizimin e kërkesës së propozuesit, andaj nuk ekziston asnjë rrezik që paditësi/propozuesi në të ardhmen të mos mund ta realizojë kërkesën e tij, në rast se kërkesëpadija e tij për anulim të pjesshme të kontratës dhe kompensimin e plotë të aksioneve rezulton si e bazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka marrë këtë vlerësim juridik se me nenit 297 pikën 1) nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se; *“Masa e sigurimit mund të caktohet; a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështërsonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetësimin e pasurisë së vet, me fshehejen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*.

Bazuar në dispozitën e lartëcekur duhet të plotësohen dy kushtet ligjore;

- propozuesi i masës së sigurimit duhet ta bëjë të besushëme ekzistimin dhe besushmërin se pa një masë të tillë kundërpropozuesi do të pamundësonte apo vështërsonte në mënyrë të dukshme realizimin e kërkesës, dhe

- nëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar, kundërpropozuesi do ta vështërsonte dukshëm realizimin e kërkespadiës e sidomos me tjetërsimin e pasurisë me fshehjen e saj, me ngarkimin apo ndonjë mënyrë tjetër do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese ose në një mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të masës së sigurimit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushtet e sipërmendura e që në rastin konkret nuk janë plotësuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë fakti se në këtë fazë të procedurës nuk janë ofruar prova dhe rrethanat bindëse lidhur me besushmërinë e kërkesës lidhur me caktimin e masës së sigurisë. Ajo që është më kryesorja nuk plotësohet kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurisë ngase, në rastin konkret paditësi ka dështuar të ofroj provë se kundërpropozuesi do të bënte të pamundësonte ose dukshëm do të vështërsonte realizimin e kërkespadiës.

Sikur se shihet masa e propozuar në rastin konkret nuk ka të bëjë me pamundësin e realizimit të kërkespadiës, respektivisht edhe pa masën e sigurisë kërkespadija e paditësit mund të realizohet në rast se rezulton si e bazuar. Më saktësisht në mënyrë se si është propozuar masa e sigurisë nuk është e qartë se cilën pasuri mund të fsheh, ngarkojë, apo ta tjetërsojë kundërshtarët e sigurimit, andaj sipas shkresave të lëndës nuk rezulton se në rast të mos caktimit të masës së sigurisë, propozuesi do të ketë dëm të pariparushëm.

Andaj kolegji e dhomës së shkallës së dytë i vlerësoj edhe pretendimet e tjera ankimore të propozuesit të sigurimit por gjeti se të njejtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi i gjykatës së parë.

Nga të cekurat më lartë e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1391/24,data 02.09.2024

Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri